



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV<sup>1</sup>**  
**MD. NR. 11/2023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT**  
**ADMINISTRATIV MD-NR. 01/2019 PËR MËNYRËN E DHËNIES DHE**  
**PROGRAMIN E PROVIMIT PËR NOTERINË**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ MD. Nr. 11/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 01/2019 për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit për Noterinë, i nënshkruar nga Ministrija e Drejtësisë më datë 23.10.2023

Ministrja e Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L -10 për Noterinë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-149, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe duke u bazuar në Shtojcën 1, pika 3 të Rregullores (QRK) - Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**  
**MD. NR. 11/2023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT**  
**ADMINISTRATIV MD-NR. 01/2019 PËR MËNYRËN E DHËNIES DHE**  
**PROGRAMIN E PROVIMIT PËR NOTERINË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MD-NR. 01/2019 për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit për Noterinë (tutje: Udhëzimi bazik)

**Neni 2**

Pas paragrafit 2 të nenit 11 të Udhëzimit bazik, shtohet paragrafi i ri si në vijim:

3. Ministria mund të ia lejojë subjekteve relevante vendore ose të huaja të monitorojnë procesin e provimit.

**Neni 3**

Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 15 të Udhëzimit bazik, riformulohen si në vijim:

1. Provimi me shkrim mbahet në të njëjtën ditë për të gjithë kandidatët.

2. Në pjesën e provimit me shkrim merr pjesë Kryetari i Komisionit dhe Sekretari i Komisionit, Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre, përfshirë stafin mbështetës sipas paragrafit 1 të nenit 3 të këtij Udhëzimi.

#### **Neni 4**

Paragrafi 1 i nenit 16 të udhëzimit bazik ndryshohet si në vijim:

1. Stafi i Ministrisë së Drejtësisë, monitoron sallat e provimit me qëllim të mbarëvajtjes së provimit dhe eliminimin e keqpërdorimeve eventuale nga ana e kandidatëve.

#### **Neni 5**

Paragrafi 3 i nenit 17 të Udhëzimit bazik, riformulohet si në vijim:

3. Pas përfundimit të pjesës së provimit me shkrim, Komisioni dhe Sekretari brenda dy (2) ditëve takohen për të filluar vlerësimin e detyrave me shkrim. Vlerësimi i detyrave me shkrim përfundon jo më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e fillimit të vlerësimit.

#### **Neni 6**

Pas paragrafit 2 të nenit 20 shtohet paragrafi i ri 2A si në vijim:

2A. Për të mbajtur rregull, Komisioni mund të kufizojë numrin e personave që dëshirojnë të jenë të pranishëm gjatë provimit me gojë.

#### **Neni 7**

Paragrafi 3 i nenit 21 të Udhëzimit bazik riformulohet si në vijim:

3. Provimi me gojë vlerësohet i kaluar nëse kandidati arrin minimumin prej 34 pikëve, me kushtin që i njëjti ka arritur të paktën minimumin e pikëve në secilën nga lëndët e përcaktuara në këtë nen.

#### **Neni 8**

Paragrafi 3 i nenit 22 të Udhëzimit bazik riformulohet si në vijim:

3. Rezultati përfundimtar i një kandidati vlerësohet nga Komisioni bazuar në rezultatin e provimit me shkrim dhe me gojë deri në 100 pikë, me kushtin që i njëjti ka arritur të paktën minimumin e pikëve në provimin me shkrim dhe minimumin e pikëve në provimin me gojë.

### **Neni 9**

Pas paragrafit 3 të nenit 6 shtohet paragrafi i ri me përmbajtjen si në vijim:

4. Në rastet kur kandidati konsideron se ekziston konflikt interesi në mes tij dhe ndonjërit nga anëtarët e komisionit i njëjti me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit njofton me shkrim Sekretarin e Komisionit.

5. Lidhur me çështjen e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni vendos Ministri i Drejtësisë.

### **Neni 10** **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albulena Haxhiu**

\_\_\_\_\_  
**Ministre e Drejtësisë**

**Datë: 23/10/2023**